



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve  
Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera  
Ministry of Finance, Labour and Transfers



AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
AGENCIJA ZA ZAPOŠLJAVANJE REPUBLIKE KOSOVO  
EMPLOYMENT AGENCY OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

**06/04/2023**

## **PROGRAMI I VETËPUNËSIMIT PËR PERSONA TË RIATDHESUAR**

### **Thirrje për Aplikim**

Ministria e Financave Punës dhe Transfereve (MFPT)/Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës (APRK) në bashkëpunim me Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) mbështetur nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)/Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar (DRPR), shpallin thirrjen e hapur për personat e riatdhesuar për dorëzimin e aplikacioneve për hapjen e bizneseve me mbështetje me mjete/pajisje teknike në kuadër të Programit të Vetëpunësimit.

### **Rreth Programit të Vetëpunësimit**

Qëllimi i Programit të Vetëpunësimit është të mbështesë personat e riatdhesuar të regjistruar si të papunë në krijimin e planeve të realizueshme të biznesit që janë në gjendje t'i mbijetojnë tregut konkurrues duke promovuar vetëpunësimin si masë aktive të tregut të punës. Mbështetja me grante do të ofrojë mjete/pajisje teknike për realizimin e Planit të Biznesit.

Programi në vazhdimësi do të asistojë në zhvillimin e biznesit përmes këshillimit për t'i ndihmuar personat e riatdhesuar të papunë dhe të kualifikuar të orientuar për të qenë të suksesshëm në fushën e zgjedhur. Programi i prezantuar i vetëpunësimit është program konkurrues për të garantuar kthimin më të lartë të mundshëm të investimit. Procesi i përzgjedhjes ka për qëllim të sigurojë transparencë dhe konkurrencë të drejtë dhe t'i mbështesë idetë dhe planet më të mira të biznesit që garantojnë rezultate të qëndrueshme.

### **Mbështetja nga programi**

Qëllimi i Programit është që të sigurojë mbështetje hap-pas-hapi për planet e biznesit që kanë mundësinë më të madhe të arrijnë sukses dhe të përballen me barrierat e ndryshme të tregut. Për këto qëllime Programi është ndarë në këto faza:

**Faza e parë:** Pjesëmarrësit e kualifikuar fillimisht aplikojnë me planin e tyre të biznesit përmes formularit të aplikimit (Planin e Biznesit) duke bashklidhur dokumentet përcjellëse

të cilin e dorëzojnë "online" përmes postës elektronike ([almp.ks@undp.org](mailto:almp.ks@undp.org)). Komisioni i verifikimit administrativ vendosë nëse Plani i Biznesit dhe dokumentacionet përcjellëse të secilit aplikant i plotësojnë kriteret për të kaluar në fazën e dytë, në vlerësimin e ekspertëve.

**Faza e dytë:** Aplikantët që kalojnë me sukses fazën e verifikimit administrativ, vlerësohen në aspektin teknik nga ana e ekspertëve ku Plani i Biznesit vlerësohet në bazë të kriterëve të programit. Përgjatë fazës së vlerësimit merren parasysh pikëpamjet përmbajtjesore të planit, lidhshmëria me referencat, përvojën e punës, certifikimin e aftësive, parashikimet financiare dhe hulumtimet e tregut. Kjo fazë përbën një proces konkurrues ku Planet e Biznesit me më së shumti pikë kalojnë në fazën finale.

**Faza e tretë:** Shpallja e rezultateve finale dhe procedurat e regjistrimit të bizneseve individuale nga përfituesit, nënshkrimi kontratës dhe pranimi i setit të mjeteve dhe pajisjeve esenciale për fillimin e biznesit sipas profilit të aprovuar.

Planet e Biznesit **të pa pranueshme** për të marrë pjesë në Program janë:

- të gjitha llojet e veprimtarive të cilat nuk janë në shtojcën **Nr. 1** të kësaj thirrjeje;
- veprimtaritë me patundshmëri, lizing;
- veprimtaritë financiare dhe të sigurimeve dhe veprimtaritë që përfshijnë bixhozin;
- prodhimi i pijeve me përmbajtje të lartë të alkoolit;
- prodhimi i produkteve të duhanit;
- prodhimi dhe shpërndarja e armëve;
- prodhimi që përdorë teknologji që çojnë në ndotje të mjedisit (si ndotje të ajrit, ujit, tokës etj.);
- bizneset joformale;
- bizneset ekzistuese – të regjistruara në ARBK;
- aktivitete biznesore nga sektori i tregtisë.

### **Aplikantët e pranueshëm**

Të gjithë aplikantët e interesuar për tu kualifikuar për aplikim, duhet të jenë persona të riatdhesuar sipas rregullores **Nr. 22/2020** për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar. Ata janë të obliguar që personalisht të marrin pjesë në fazat e Programit dhe të jenë drejtpërsëdrejti të përfshirë në zhvillimin dhe realizimin e biznesit.

Kandidatët e kualifikuar dhe pjesëmarrës në Program duhet të jenë persona të riatdhesuar në 5 (pesë) vitet e fundit të regjistruar si të papunë në Zyret e Punësimit (ZP). Të drejtë aplikimi kanë vetëm personat e riatdhesuar në Kosovë nga viti **2018**.

Aplikantët për programin e Vetëpunësimit duhet të kenë të kryer një trajnim për "Vetëpunësim" ose "Ndërmarrësi". Çertifikimi i ndonjë trajnimi tjetër të akredituar që dëshmon se e njohin profesionin përkatës në kohën e aplikimit do të jetë përparësi.

### **Personave të papunë të grupeve në vijim do t'u ipet prioritet:**

- gratë;
- të papunët afatgjatë (më shumë se 12 muaj);
- të rinjtë (18-29 vjeç);
- të mbijetuarit e dhunës në baza gjinore;
- përfitues të ndihmës sociale;
- personat e vetëm, me një ose më shumë anëtarë që varen nga ai/ajo (prindër vetëushqyes);
- personat nga viset rurale;
- personat me aftësi të kufizuara;
- grupet e pakicave etnike,
- personat që e kanë përfunduar skemën "Trajnim në Punë" në kuadër të skemave të ofruara në Zyret e Punësimit.

### **Personat që nuk kualifikohen për aplikim janë ata persona të cilët:**

- nuk janë persona të riatdhesuar në 5 (pesë) vitet e fundit (**viti 2018**);
- nuk janë të regjistruar në ZP;
- kanë përfituar më herët nga Plan Biznesi ose masa tjera aktive të punësimit (Subvencionim në Pagë);
- janë në konflikt të interesit me palë të përfshira dhe vendimmarrëse në Program;
- nëse janë të riatdhesuar për herë të dytë ose më shumë;
- personat që kanë biznes të regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës;
- të riatdhesuarit ose familjarët e të cilëve kanë përfituar Plan Biznesi siç është definuar në rregullore.

### **Mbështetja nga Programi**

Programi i Vetëpunësimit do të sigurojë **mjete dhe pajisje teknike bazike** sipas profileve të pranuara në këtë shpallje **për çdo Plan të Biznesit të zhvilluar me sukses** që është miratuar në kuadër të procesit të përzgjedhjes ku do të ofrohet mbështetje sipas Planit të Biznesit.

*Aplikantët që sigurojnë kontribut financiar (**jo-obligativ**) me minimum 500.00 Euro, do të marrin pikë shtesë nga vlerësimi i planeve të biznesit (3 pikë prej 100 në total - vetëm në rast se sillet dëshmi për bashkëfinancim). Nëse shuma e kontributit është më e vogël se ajo e përmendur më lartë, nuk do të ipen pikë shtesë.*

Përparësi do t'u ipet aplikantëve që përdorin qasje inovative, që e kursejnë energjinë elektrike, që përdorin burime të ripërtëritshme të energjisë si dhe biznese që krijojnë së paku 1 (një) vend pune (vetëm për të papunët e regjistruar).

## **Kriteret e vlerësimit të Biznes Planeve**

Çdo plan i biznesit vlerësohet në dy faza :

### 1. Verifikimi Administrativ

Verifikimi administrativ konsiston në **verifikimin e plotësisë dhe vërtetësisë së dokumenteve të kërkuara nga Programi. Disa nga elementet që verifikohen janë:**

- Modeli i Planit të Biznesit dhe bashkëlidhjet;
- Data e riatdhesimit (të drejtë aplikimi kanë vetëm personat e riatdhesuar në Kosovë prej vitit **2018**).
- Posedimi i certifikatës së trajnimit për Vetëpunësim ose Ndërmarrësi;
- Statusi i riatdhesimit: vërtetim nga ZKKK, Travel Dokument ose Vulen Hyrëse, si dëshmi se personi është i riatdhesuar;
- Posedimi i referencave nga punëdhënësit paraprak (me informata të sakta mbi punëdhënësin dhe e vulosur);
- Posedimi i certifikatave për njohjen e profesionit, diplomave etj.

### 2. Vlerësimi Teknik

Vlerësimi bëhet nga dy ekspertë. Secili ekspert e vlerëson Planin e Biznesit dhe nuk i diskuton vlerësimet e tij/saj me të tjerët. Nëse ndryshimi ndërmjet rezultateve të dy ekspertëve është më i madh se 15 (pesëmbëdhjetë) pikë, plani i biznesit i jepet një eksperti tjetër për një vlerësim të tretë. Rezultati përfundimtar për këtë Plan të Biznesit është rezultati mesatar i dy vlerësimeve.

Rezultati maksimal është 100 (njëqind) pikë dhe vlerësohet sipas kriterëve të mëposhtme:

- Realizueshmëria financiare e biznesit;
- Resurset në dispozicion për biznesin – objekti, pajisjet, furnizimet dhe stafi;
- Njohja e llojit përkatës të biznesit, organizimi i biznesit dhe menaxhimi i rrezikut;
- Vlerësimi i tregut, njohja e konkurrencës dhe marketingu.

## **Si të aplikoni**

Të gjithë personat e interesuar që i plotësojnë kushtet për aplikim, të kompletojnë **Formularin e Aplikimit për Plan të Biznesit** dhe ta dorëzojnë atë përmes postës elektronike: [almp.ks@undp.org](mailto:almp.ks@undp.org) deri me datën e paraparë në thirrjen për aplikim të shpallur në ueb site të APRK-së. **Në linkun në vijim, janë dhënë udhëzimet se si ta plotësoni Planin e Biznesit, hap pas hapi:**

[https://www.youtube.com/channel/UCze7p4yt6uv6VKuloQs8JAA?vieë\\_as=subscriber](https://www.youtube.com/channel/UCze7p4yt6uv6VKuloQs8JAA?vieë_as=subscriber)

Aplikantët janë të obliguar të sigurojnë si bashkëlidhje në mënyre elektronike *Formularin e Aplikimit, kopjen e dokumentacionit që dëshmon që është i/e riatdhesuar, CV-në e tyre nga SIMP (nga Zyra e Punësimit), certifikatën e trajnimit në Qendrën e Aftësisit Profesional (nëse*

e posedojnë), certifikaten e trajnimit nga ndonjë organizatë tjetër e akredituar, dëshmi mbi kualifikimin dhe përvojën e tyre që përputhet me idenë e paraqitur të biznesit si dhe dokumentet tjera përcjellëse të cilat përshkruhen në Planin e Biznesit (pjesa e Udhëzimeve).

**Çdo aplikacion i dërguar i pa plotësuar me dokumentacion përkatës dhe pas afatit të fundit të shpallur në postën elektronike [almp.ks@undp.org](mailto:almp.ks@undp.org), konsiderohet i pavlefshëm.**

**Data e fundit e dorëzimit të aplikimeve është e 22 Maj 2023, në orën 16:00.**

**Secili aplikant mund të aplikojë me vetëm një Plan të Biznesit (një anëtar për familje).**

**Informata të detajzuara mund të gjeni në thirrjen për aplikim dhe udhëzime tek Formulari i Aplikimit.**

Informata shtesë dhe Formulari i Aplikimit mund të gjenden në: <https://apr.k.rks-gov.net> dhe në secilën Zyre të Punësimit në Kosovë.

Në rast se keni pyetje shtesë për programin e vetëpunësimit, ju lutem kontaktoni zyrën e projektit përmes postës elektronike: [almp.ks@undp.org](mailto:almp.ks@undp.org)

### **Rreth projektit ALMP2 në UNDP Kosovë**

Objektivi kryesor i Programeve Aktive të Tregut të Punës (PATP/ALMP) është përmirësimi i kapaciteteve të institucioneve të tregut të punës për të hartuar politikat relevante të përgjegjshme-gjinore në nivelin qendror dhe ofrimi i shërbimeve të integruara në nivel lokal, duke u fokusuar në grupet më të cenueshme në mesin e të papunëve.

Gjithashtu, projekti ofron mundësi për punësim dhe trajnim për personat e papunë të regjistruar në Zyret e Punësimit në të gjithë Kosovën përmes programeve të ndryshme aktive si: Subvencionimi i Pagave (SP), Trajnim në Punë (TP), Praktikë në Punë (PP) dhe Vetëpunësim (VP)

## **Shtojca 1: PROFESIONET E PRANUARA PËR TË CILAT OFROHEN MJETE DHE PAJISJE SIPAS SEKTORËVE**

- Përpunimi i ushqimit dhe industria e paketimit:
  - **Përgaditja e brumërave dhe ëmbëlsirave**
  - **Përgaditja e ushqimeve të shpejta**
- Ndërtimtaria:
  - **Instalues i ngrohjes qendrore**
  - **Suvatues /Fasadues**
  - **Instalues i sanitarisë/qeramikës**
  - **Instalues elektrik**
  - **Murator**
- Industria e përpunimit të metalit:
  - **Saldues/Metalpunues**
- Industria e tekstilit:
  - **Rrobaqepës**
  - **Qëndisje**
- Industria e përpunimit të drurit:
  - **Zdrukthëtar/Mobileri**
- Agrokulturë:
  - **Serë**
- Tjera:
  - **Floktar/Thonjë**
  - **Floktar/Depilim**
  - **Berber**
  - **Auto-Ngjyrosje**
  - **Auto-Mekanik**
  - **Gomister**
  - **Auto-Larje**
  - **Pastrim gjeneral**

**Vërejtje: Aplikanti duhet ta zgjedhë vetëm njërin nga profilet e lejuara. Profile tjera që nuk janë listuar në këtë listë nuk mbështeten nga Programi. Ofertat/faturat nuk pranohen si dokumentacion përbërës në kuadër të aplikimit. Pako e pajisjeve është e përcaktuar sipas profilit. I gjithë procesi i aplikimit është pa pagës.**